



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. 1047 prot.

Gjirokastrë, më 02.07. 2024

APROVOI
REKTOR
Prof. dr. Bektash MEMA



Lënda: Hapet thirrja për shkëmbim staf në kuadër të Programit Erasmus+ në Universitetin Mesdhetar të Kretës.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti i Kretës hap thirrjen për shkëmbim staf me Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë.

Sipas Marrëveshjes Ndërinstitucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me **1 pozicion** për staf akademik ose administrativ, i cili do të angazhohet në mësimdhënie ose trajnim në Universitetin e Kretës. Aktiviteti do të zhvillohet gjatë vitit akademik **2024-2025**. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht ose greqisht.

Të interesuarit duhet të dërgojnë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **19.07.2024**:

- fotokopje të kontratës së punës;
- letër interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në anglisht;
- provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze ose greke, të paktën në nivelin B1;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ-së, dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet Universitetit të Kretës, për përzgjedhjen përfundimtare të aplikantit/aplikantes.

Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor

Irma Gjollëshi